


INTEGRIMI I POLICISË NË KOSOVËN VERIORE: PROGRESI DHE SFIDAT E MBETURA NË ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BRUKSELIT



Belgrade Centre for Security Policy



Integrimi i policisë në Kosovën Veriore: Progresi dhe sfidat e mbetura në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit

Beograd dhe Prishtinë
2014

Botuesit:

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë
[QBPS] dhe Qendra Kosovare për Studime të
Sigurisë [QKSS]

Autorë:

Maja Bjeloš dhe Bojan Elek
[Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë]

Bashkautor:

Fjolla Raifi
[Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë]

Redaktor:

Florian Qehaja

Beograd dhe Prishtinë 2014

© QBPS dhe QKSS

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

ISBN 978-9951-679-03-9

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.74(496.51-17)

327(496.51:4/9)

Integrimi i policisë në Kosovën Veriore : progresi dhe sfidat e mbetura në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit / Maja Bjeloš, Bojan Elek, Fjolla Raifi. - Prishtinë ; Beograd : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ; Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, 2014. – 18 f. ; 30 cm.

Bibliografia : f. 15-18

1. Bjeloš, Maja 2. Elek, Bojan 3. Raifi, Fjolla

ISBN 978-9951-679-03-9

Ky publikim është hartuar në kuadër të projektit 'Forumi Hulumtues i Sigurisë: Beograd-Prishtinë-Tiranë' i përkrahur nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë. Hulumtimi është përkrahur nga Programi për Shkëmbimin e Punës Profesionale i Trustit Ballkanik për Demokraci dhe nga Zyra e Komonveltit të Mbretërisë së Bashkuar.

Qëndrimet dhe analizat që përmban ky publikim janë qëndrime të autorëve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e qeverisë norvegjeze dhe të Mbretërisë së Bashkuar ose të ndonjë organizate përkatëse të tyre.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument paraqet një analizë alternative për zbatimin e Marrëveshjes së arritur në Bruksel në Prill të vitit 2013 ndërmjet kryeministrave të Serbisë dhe të Kosovës. Pjesa e parë e Marrëveshjes thekson shprehimisht se njësitë lokale të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP) do të shpërbëhen dhe integrohen në Policinë e Kosovës (PK). Marrëveshja e Brukselit po ashtu ka përcaktuar obligimin për krijimin e një Komande Rajonale të PK-së në Veri, përgjegjëse për të mbuluar katër komunat veriore me shumicë serbe.

Gjetjet e kësaj analize tregojnë se deri në fund të muajit mars 2014, 285 ish punonjës të MUP-it duhet të fillojnë procesin e integritimit. Kjo ka shënuar një hap të rëndësishëm përpara në zbatimin e Marrëveshjes. Ka pasur disa paqartësi dhe sfida lidhur me krijimin e Komandës Rajonale të PK-së për Veriun, veçanërisht rreth asaj se a duhet kjo Komandë të përfshijë vetëm katër komunat serbe në veri, apo edhe ato të Mitrovicës Jugore dhe të Vushtrrisë. Përveç kësaj, ka pasur disa mosmarrëveshje lidhur me emërimin e Komandantit të Veriut, post i cili për momentin mbahet nga ushtruesi e detyrës së komandantit Nenad Djurić. Përveç këtyre çështjeve organizative, pika kryesore e mosmarrëveshjes kishte të bënte me procesin e verifikimit, i cili u kritikua për shkak të kohës së kufizuar për zhvillimin e tij dhe vështirësive që të zbatohet cikli i përgjithshëm i verifikimit. Çështja se kush duhet të ketë përgjegjësinë për procesin e verifikimit ishte dominuese në diskursin politik si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd. Për më tepër, trajnimi fillestar i cili u organizua për ish-pjesëtarët e MUP-it ishte i shkurtër, çka ngriti pastaj çështjen e integritimit të duhur dhe përshtatjes së tyre në strukturën organizative të PK-së. Përveç kësaj, gjatë bisedimeve në Bruksel pala serbe ja dorëzoi autoriteteve të Prishtinës një listë prej 337 policëve të cilët duhej të integroheshin. Prej këtyre, 285 u ftuan t'i bashkëngjiten procesit të integritimit, ndërsa 52 ish pjesëtarë të MUP-it u hoqën nga lista. Ndër këta 52 pjesëtarë kishte të atillë që nuk

dëshironin t'i bashkohen PK-së, disa kishin aplikuar por nuk i kishin plotësuar të gjitha kushtet dhe disa nuk kishin kaluar verifikimin e sigurisë. Përveç këtyre, përafërsisht 800 ish pjesëtarë të stafit të MUP-it në Kosovën qendrore dhe lindore u pensionuan ose u hoqën nga procesi i integritimit. Kjo shkaktoi pakënaqësi tek këta persona, si dhe ankesa se Marrëveshja e Brukselit po aplikohet vetëm për Kosovën Veriore.

Si pjesë e diskutimeve të përgjithshme, në media është paraqitur një numër raportesh të cilat ngjallën keqinterpretime dhe paragjykime lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit. Përderisa mediat kosovare, për shembull, ngritën çështjen e lojalitetit të këtyre pjesëtarëve ndaj zinxhirit komandues të PK-së, mediat serbe e trajtuan këtë temë gjerësisht, duke u fokusuar në aspektet teknike të procesit, siç ishte sfida e integritimit të një numri të madh të pjesëtarëve të MUP-it në PK dhe procedura e verifikimit të sigurisë, mes çështjesh tjera, pothuaj ekskluzivisht duke cituar mediat kosovare.

HYRJE

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, dialogu politik edhe jostabil ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës u bllokua tërësisht. Tek në vitin 2011 filloi një rund i ri i bisedimeve me ndërmjetësimin e BE-së, në të cilin u trajtuan aspektet teknike të marrëdhënive Kosovë-Serbi. Dy vite pas rifillimit të negociatave, në Prill të vitit 2013 u arrit Marrëveshja e parë për Parimet e Normalizimit të Marrëdhënive [të cilës më poshtë i referohemi me emrin e saj të zakonshëm, Marrëveshja e Brukselit]. E konsideruar si moment historik në marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, Marrëveshja e Brukselit e përcaktoi kornizën ligjore për integritimin e komunitetit serb në Kosovën Veriore në institucionet kosovare. Kjo u konsiderua si hap historik përpara, pasi që një gjë e tillë kishte qenë e paimagjinueshme dy vite më herët. Megjithatë, ky hap nuk është pranuar plotësisht nga të gjitha palët e interesit dhe nga qytetarët në Serbi, përfshirë edhe nga serbët e Kos-

ovës; ngjashëm, Marrëveshja është kritikuar ashpër edhe nga disa shqiptarë të Kosovës sepse konsiderohej se e dëmton integritetin territorial të Kosovës dhe se u garanton autonomi territoriale serbëve të Kosovës. Në mesin e dispozitave të tjera, Marrëveshja i dha fund funksionimit të strukturave të policisë nën autoritetin e MUP-it të Serbisë në Kosovën Veriore.¹ Marrëveshja e Brukselit është plotësuar me një Plan të Zbatimit, i cili u miratua me 22 maj 2013. Ky plan ofroi informacione për zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit, duke specifikuar arritjet konkrete dhe afatet kohore për arritjen e tyre (Plani i Zbatimit 2013). Megjithatë, asnjëri prej këtyre dokumenteve nuk u publikua në faqet e internetit të qeverive të Serbisë dhe Kosovës. Dokumentet e vetme që u vunë në dispozicion ishin ato të botuara në gazeta, të cilat nuk ishin sa duhet të sakta lidhur me aktorët e përfshirë në proces dhe përgjegjësitë e tyre, duke lënë kështu hapësirë për interpretime dhe zbatim të ndryshëm në praktikë.

METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij dokumenti është që të ofrojë një analizë alternative mbi zbatimin e atyre pjesëve të Marrëveshjes së Brukselit që kanë të bëjnë me integrimin e ish punonjësve të MUP-it në Policinë e Kosovës (PK). Ky dokument synon të paraqes progresin e arritur deri më sot, si dhe sfidat e hasura deri më tani si rezultat i informacioneve të pamjaftueshme që u janë dhënë audiencave si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Prandaj ky dokument paraqet një burim alternativ të informatave të përgatitura në mënyrë të pavarur nga dy forume të pavarura.

Ky hulumtim bazohet në një shqyrtim të gjerë të dokumenteve politike dhe ligjore, botimeve shkencore, raporteve zyrtare të përpiluara

nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore dhe artikujve të gazetave. Përveç analizimit të burimeve të shkruara, janë siguruar edhe të dhëna empirike përmes 15 intervistave individuale me palët kyçe në Kosovë, përfshirë edhe ato me përfaqësuesit e PK-së në Zyrën Qendrore në Prishtinë dhe në komandën rajonale të Mitrovicës Veriore, me anëtarët e Kuvendit dhe me përfaqësuesit e OSBE-së dhe EULEX-it (për listën e plotë të intervistave, shih *Shtojcën 1*). Këto intervista janë zhvilluar në fund të muajit shkurt dhe në fillim të marsit 2014. Disa kufizime të kësaj qasjeje ishin gatishmëria e ulët e disa zyrtarëve në Beograd që t'i përgjigjen pozitivisht kërkesave për intervista, me siguri për shkak se situata politike ishte shumë e paqëndrueshme, për faktin se zgjedhjet parlamentare ishin parapare të mbahen me 16 mars. Kufizimet e tjera përfshijnë kohën e shkurtër që ishte në dispozicion për të punuar në terren dhe pamundësinë për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse performancën e policëve serbë meqë ata e kishin përfunduar trajnimin kohëve të fundit (grupi i fundit i policëve e kishte përfunduar trajnimin në shkurt 2014).

Ky projekt hulumtues është zhvilluar nën kujdesin e Forumit Hulumtues të Sigurisë Beograd – Prishtinë, iniciativë rajonale trevjeçare e përkrahur nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme me qëllim të përmirësimit të dialogut për çështje të sigurisë ndërmjet akademikëve, shoqërisë civile dhe medie në marrëdhëniet serbo-shqiptare. Hulumtimi në terren është zhvilluar në fund të muajit shkurt dhe fillim të marsit 2014, si pjesë e Programit e Trustit Ballkanik për Demokraci për Shkëmbimin e Punës Profesionale dhe Përmirësimin e Politikës së Dialogut. Ky program është përkrahur nga Ministria e Jashtme dhe e Komonveltit e Mbretërisë së Bashkuar.

¹ Një pikë e mbetur kontestuese është ekzistenca e një-sive të mbrojtjes civile në Veri. Sipas ligjeve të Serbisë, këto njësi janë përgjegjëse për fatkeqësi natyrore dhe ato që shkaktohen nga njeriu dhe funksionojnë nën autoritetin e komunave. Megjithatë, qeveria e Kosovës i konsideron ato si vazhdim i forcave serbe të sigurisë që ende veprojnë në Veri dhe është për shpërbërjen e tyre.

BAZA KONCEPTUALE E MARRËVESHJES SË BRUKSELIT: NJË HAP PËRPARA

Përfaqësimi i komuniteteve etnike në mekanizmat e sigurisë në Kosovë kryesisht përcaktohet nga niveli i integritit të secilit komunitet në shoqërinë kosovare dhe në dinamikën politike. Një prej aspekteve më sfidauese të integritit të komuniteteve etnike vazhdon të jetë akomodimi i komunitetit etnik serb në institucionet kosovare të sigurisë. Ndeshmëria politike në mes të dy vendeve ka qenë treguesi kyç i përfaqësimit dhe integritit të komuniteteve etnike në institucionet e Kosovës, veçanërisht në strukturat e sigurisë.

Me përfundimin e konfliktit në vitin 1999, Policia e Kosovës u fut nën mbikëqyrjen e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe të OSBE-së, të cilat ndërmorën një varg iniciativash të vazhdueshme dhe të suksesshme për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet PK-së dhe komuniteteve pakicë. [Raporti i OSBE-së 2001: 27] Misioni i OKB-së kishte për qëllim të arrijë një nivel të përfaqësimit të komuniteteve etnike në procesin e vendimmarrjes në përpjesëtim të njëjtë me pjesëmarrjen në numrin e popullatës në përgjithësi, veçanërisht kur ishte fjala për përfaqësimin e serbëve etnik në strukturat e PK-së. [ISS 2012:5] Thënë në mënyrë më specifike, policët serbë të Kosovës janë emëruar në stacionet policore që gjenden në komunitetet pakicë, çka rezultoi me një progres pozitiv në përmirësimin e nivelit të besimit në polici. [Raporti i OSBE-së 2001:28]

Sidoqoftë, shpallja e pavarësisë së Kosovës me 2008 shënoi sfidën më të madhe dhe situatën më kritike sa i përket përfaqësimit të serbëve etnik në strukturat e PK-së. Për shkak të situatës politike dhe pas kërkesave të zyrtarëve të Beogradit, shumica e policëve serbë i braktisën pozitat e tyre dhe refuzuan të kryejnë detyrat e tyre ditore. [Raporti i ICG-së 2009: 14] Si rezultat, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me EULEX-in dhe me strukturat e tjera ndërkombëtare në Kosovë, e cak-

toi Qershorin e vitit 2009 si afat për serbët e Kosovës që të kthehen në vendet e punës ose përndryshe për pozitat e tyre do të rihapen konkurset dhe do të punësohen policë të rinj [Emini 2013:14]. Kjo strategji ishte e suksesshme dhe shumica e policëve serbë u kthyen në pozitat e tyre të mëparshme [Raporti i ICG-së 2009:14]. Është raportuar se 307 nga 325 policët serbë janë kthyer në pozitat e tyre të mëparshme [QKSS, 2009: 80]. Prej vitit 2009, përfaqësimi i komunitetit etnik serb në strukturat e PK-së në mënyrë të qëndrueshme është kthyer në nivel të kënaqshëm.

Përfaqësimi i komuniteteve etnike në Policinë e Kosovës rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Policinë e Kosovës, si dhe legjislacionin dhe procedurat sekondare. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës “Policia është profesionale dhe pasqyron llojllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.” [Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, Neni 128/2] Në mënyrë më specifike, Neni 35 i Ligjit për Policinë e Kosovës [LPK] shprehimisht thekson se “përbërja etnike e policisë në kuadër të komunës, deri në nivelin e mundshëm, do ta përfaqësojë përbërjen etnike të popullatës së asaj komune.” [LPK 03/L-076 Neni 35] Në mënyrë të veçantë, korniza ligjore e Policisë së Kosovës përcakton emërimet e Komandantëve të Stacioneve sipas komunitetit etnik që banon në një territor përkatës. Kjo në mënyrë specifike rregullohet në Nenin 41 i cili thekson se “Në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik, Komandantët e Stacioneve Policore dhe Komandantët e nënstacioneve i përzgjedh Drejtori i Përgjithshëm me pjesëmarrjen e Kuvendit Komunal.” [LKP 03/L-076 Art 41].

Në vitin 2013, PK është konsideruar “kampion” në mesin e institucioneve të Kosovës sa i përket përfaqësimit të pakicës etnike serbe. Sipas statistikave të saj, PK ka vazhduar të ndjek ketë praktikë të shkëlqyeshme të përfaqësimit etnik, veçanërisht sa i përket komunitetit serb. Thënë më saktë, në fund të vitit 2013, rreth 11.49% e stafit të PK-së ishin ser-

bë, duke përfshirë personelin me uniformë dhe atë civil. [Emini, 2013: 15]

një rol në ofrimin e sigurisë në Kosovën Veriore. I tërë komunikimi ndërmjet institu-

Tabela 1: Përfaqësimi i komunitetit serb në Policinë e Kosovës*

Staf i uniformuar dhe civil	11.49%
Staf i uniformuar	12.01%
Staf civil	8.04%

* Të dhënat e paraqitura janë për periudhën deri me 2013.

Më poshtë është dhënë numri i serbëve në grada të ndryshme në vitin 2013:²

cioneve kosovare të sigurisë dhe institucioneve të sigurisë në Kosovën veriore ishte bërë

Zëvendësrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës	1
Kolonel	1
Nënkolonel	1
Major	3
Kapiten	9
Toger	12
Rreshter	56
Policë	585
GJITHSEJTË	668

Gjendja lidhur me përfaqësimin e serbëve etnik në strukturat e PK-së në Kosovën Veriore është krejtësisht ndryshe dhe më sfiduese, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. MUP-i i Serbisë dhe Agjencia e Sigurimit dhe Inteligjencës (BIA), krahas strukturave të tjera shtetërore të Serbisë, kishin dominuar gjatë kësaj periudhe. Deri më 2008, stacioni policor në komunën e Mitrovicës dhe komandanti i policisë në rajonin e Mitrovicës ishin të vetmet struktura të sigurisë që akoma nuk ishin integruar në strukturat e Policisë së Kosovës. [ISS 2012: 13] Policët serbë vazhduan të marrin pagat e tyre nga Beogradi dhe u ballafaquan me një presion të madh nga komuniteti që të rrinë larg nga strukturat e PK-së. Vakumi i sigurisë i bëri strukturat shtetërore serbe të sigurisë të vetmet ofruesë thelbësor të sigurisë. Megjithatë, krahas institucioneve serbe të sigurisë, EULEX-i dhe KFOR-i po ashtu patën

me ndërmjetësimin e EULEX-it, i cili po ashtu kishte qasje të kufizuar. [ICG, 2011: 3]

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Brukselit në prill 2013, ka filluar gradualisht procesi i integritit të ish-pjesëtarëve të MUP-it në Policinë e Kosovës. Kosova dhe Serbia janë pajtuar për një plan 15 pikësh që fokusohet në normalizimin e situatës në Kosovën Veriore përmes tre hapave konkretë: integritit të qytetarëve serbë në institucionet e Kosovës, shpërbërjes së strukturave ilegale serbe të cilat kanë funksionuar në Kosovë që nga viti 1999 dhe vazhdimin të integritit evropian për të dy vendet [Marrëveshja e Brukselit 2013].

Nenet 7, 8 dhe 9 të Marrëveshjes së Brukselit shprehimisht përcaktojnë garancitë ligjore për çështjet e sigurisë. [Marrëveshja e Brukselit 2013] Që të tri këto pika e përcaktojnë integritin e individëve serbë dhe të gjitha strukturave paralele në Kosovën Veriore në institucione dhe në strukturat ekuivalente të sigurisë në Kosovë. Në mënyrë më specifike, Marrëveshja thekson se *'Do të jetë një forcë*

² Të dhënat e paraqitura janë për periudhën deri me 2014.

policore e quajtur Policia e Kosovës. E tërë policia në Kosovën veriore do të integrohet në kuadër të Policisë së Kosovës. [Marrëveshja e Brukselit 2013: Neni 7] Si rezultat, të gjithë pjesëtarëve të strukturave të ndryshme serbe të sigurisë do tu ofrohet një pozitë në institucionet dhe strukturat ekuivalente të sigurisë së Kosovës. [Marrëveshja e Brukselit 2013: Neni 8] Ish policët e MUP-it të Serbisë në veri do të integrohen në strukturat e sigurisë së Kosovës, ndërsa Njësitë e Mbrojtjes Civile, të cilat ende veprojnë në Veri, kanë mbetur pikë kontestuese ndërmjet palës serbe dhe asaj kosovare dhe do të adresohet në të ardhmen. [Qeveria e Kosovës 2014]

Për të siguruar integrimin e plotë dhe të tërësishëm të komunitetit serb në strukturat e sigurisë në Kosovën Veriore, Marrëveshja në mënyrë specifike përcakton emërimin e Komandës Rajonale të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe: Mitrovicën Veriore, Zveçanin, Zubin Potokun dhe Leposaviq. [Marrëveshja e Brukselit 2013, Neni 9] Megjithatë, kjo dispozitë ka implikime të mëdha për kornizën ekzistuese ligjore dhe për rregulloret e strukturave të Policisë së Kosovës. Në mënyrë specifike, Ligji për PK-në (LPK) shprehimisht përcakton vetëm gjashtë rajone policore në tërë territorin e Kosovës. [LKP 03/L-076 Neni 40] Në mënyrë ideale, sipas zyrtarëve të Kosovës, katër komunat në Kosovën Veriore do të futeshin në një grup me Mitrovicën Jugore dhe Vushtrrinë nën një stacion të vetëm rajonal të policisë. [Isufi 2014] Megjithatë, meqë marrëveshja e arritur nga dy kryeministrat bën thirrje për krijimin e një rajoni të veçantë të policisë në Kosovën Veriore, Ligji për Policinë e Kosovës duhet t'i nënshtrohet modifikimeve dhe ndryshimeve specifike. [Isufi 2014] Sikurse në komunat e tjera të Kosovës, përbërja e PK-së në Kosovën Veriore do të pasqyrojë përbërjen etnike të popullsisë në katër komunat përkatëse. Në mënyrë specifike, Komandanti Rajonal i PK-së do të jetë serb i Kosovës i emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe i propozuar nga kryetarët e katër komunave veriore me shumicë serbe në emër të Bashkësisë/Asociacionit të komunave me

shumicë serbe në Kosovë. [Marrëveshja e Brukselit 2013]

PROGRESI NË ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BRUKSELIT

Dispozitat e Marrëveshjes së Brukselit që kanë të bëjnë me sigurinë, siç specifikohet në Planin e Zbatimit, përfundimisht janë zbatuar, edhe pse jo brenda afateve të dakorduara. I tërë procesi mbeti prapa afateve zyrtare të dakorduara dhe BE bëri presion, si mbi Serbinë ashtu edhe mbi Kosovën, që të tregojnë disa rezultate konkrete me kohë për samitin e Këshillit Evropian në dhjetor.³ Aktorët kryesorë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes ishin: autoritetet qeveritare të Serbisë, përgjegjëse për shpërbërjen e stacioneve të policisë në Veri dhe të obliguara të pensionojnë tërë personelin e tyre të punësuar aktualisht në Kosovë dhe tua dorëzojnë autoriteteve kosovare listën e policëve serbë që do t'i bashkëngjiten PK-së; institucionet qeveritare të Kosovës, përgjegjëse për integrimin e ish pjesëtarëve të MUP-it, përfshirë edhe trajnimin e tyre dhe caktimin në pozita të reja; dhe bashkësia ndërkombëtare, në radhë të parë EULEX-i, i ngarkuar që të sigurojë dhe lehtësojë procesin e tranzicionit sipas dispozitave të dakorduara.

Hapat fillestarë

Siç është përcaktuar në Planin e Zbatimit, afati kohor për të cilin është arritur pajtimi zyrtar për ofrimin e informatave të detajuara për numrin dhe gradat e pjesëtarëve të MUP-it që do të integrohen në PK ishte mesi i qershorit, përderisa mesi i korrikut 2013 ishte afati i dakorduar për shpërbërjen e stacioneve të policisë në Veri. Sipas një raporti të qeverisë, procesi i integritimit është dashur të zhvillohet në të njëjtën kohë me procesin e

³ Zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit ishte konsideruar si test i lakmuesit për fillimin zyrtar të negociatave të Serbisë për anëtarësim në janar 2014. Në të njëjtën kohë, edhe negociatat ndërmjet BE-së dhe Kosovës për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit janë varur nga zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit.

shpërbërjes së stacioneve të policisë. Megjithatë, procesi u vonua për shkak se pala serbe nuk e paraqiti listën e individëve të interesuar që të bëhen pjesë e institucioneve të sigurisë në Kosovë deri me 16 shtator 2013. Qeveria e Kosovës nuk e mori listën deri më 11 dhjetor 2013, dhe procesi i integritit filloi menjëherë pas kësaj. [Qeveria e Kosovës 2014] Drejtoria e Policisë së MUP-it për Mitrovicë e përpiloi listën prej 337 policëve nga veriu dhe ia dorëzoi atë qeverisë së Serbisë, e cila ja paraqiti këtë listë zyrtarëve të Prishtinës gjatë bisedimeve të Brukselit. [Djurić 2014]

The Vetting Process

Nga ky moment e tutje qeveria e Kosovës ishte përgjegjëse që të siguroj që policët serbë të integrohen në mënyrë të suksesshme në PK. Pas marrjes së listës, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës (MPB) ia dërgoi listën PK-së për verifikim dhe kontroll të përgjithshëm për të bërë verifikimin e sigurisë për ata policë. Verifikimi u bë me procedurë të përshpejtuar, duke mbuluar [ndoshta vetëm] verifikimin e identitetit dhe të dhënave mbi aktivitetet kriminale të cilat nuk ishin të përfshira në Ligjin për Amnistinë. [Djurić 2014] Për shkak se procesi i verifikimit u zhvillua tepër shpejtë, shumë çështje mbetën të pazgjydhura ose të papërfunduara.

Procedura e verifikimit u zhvillua bashkërisht nga Agjencia për Regjistrimin Civil, Policia e Kosovës dhe EULEX-i, ndërsa Agjencia Kosovare për Inteligjencë (AKI) u përfshi vetëm në verifikimin e pjesëtarëve të lartë të policisë [pozita në hierarkinë e lartë] të cilëve duhej tu bëhej verifikimi i sigurisë nga AKI në mënyrë që ata të kryejnë detyra që kërkojnë qasje në informata të besueshme dhe operativ.⁴ Megjithatë, për shkak të mungesës së kohës procedura e verifikimit të sigurisë që përcaktohet në Ligjin për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë nuk është zhvilluar akoma dhe për momentin nuk është e

qartë se kur dhe si do të zhvillohet ajo. Për shembull, neni 30 i ligjit thekson se verifikimi i thjeshtë i sigurisë së personave që do të kenë qasje në informatat e klasifikuara jo më lartë se “KONFIDENCIALE” duhet të përfundojë brenda tre muajve nga dita kur fillohet procedura, ndërsa procedura e verifikimit zgjati vetëm disa ditë apo javë. Pas këtij verifikimit, policët u ftuan që të aplikojnë për pozitat në PK. Pas plotësimit të aplikacioneve, policët nënshkruan kontratat me PK-në dhe u dërguan për trajnim në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Në fillim, policët serbë hezituan dhe ishin mjaft skeptik për procesin dhe në përgjithësi për zbatimin e Marrëveshjes. Megjithatë, ndërmjetësimi i EULEX-it dhe OSBE-së solli rezultate pozitive dhe ata u pajtuan që të marrin pjesë në trajnim në Vushtrri.

Disa qytetarë të Kosovës dhe disa parti opozitare ishin mjaft skeptike rreth zhvillimeve të reja lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit. Mungesa e informatave të sakta ngjalli dyshime të mëtejshme rreth profilit të ish pjesëtarëve të MUP-it që duhet të integroheshin, rreth trajnimit të tyre dhe rreth statusit të tyre të banimit [përfshirë edhe shtetësinë e Kosovës]. Në mediat kosovare pati raporte edhe për implikimet e mundshme të një numri të ish pjesëtarëve të MUP-it që ishin caktuar në zinxhirin komandues të PK-së, përfshirë edhe dyshimet për lojalitetin e tyre. Mediat, ekspertët dhe në përgjithësi shoqëria civile kërkonin nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI) që të zhvillonte procedurë të përgjithshme të verifikimit si pjesë e procesit të integritit. [Zejneli 2013]

Trajnimi

Trajnimi i policëve serbë u zhvillua në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, nga mesi i dhjetorit 2013 deri në fillim të shkurtit 2014. Programi i trajnimit ishte i shkurtër dhe i modifikuar dhe në vend të programit të rregullt gjashtëmujor, ai u zhvillua për një periudhë njëjavore. Kjo u bë sepse ish-pjesëtarët e MUP-it tashmë kishin përvorë të gjatë dhe kishin zhvilluar aftësitë e tyre

4 Për më shumë informata, shih: <http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/367064/Rukovodioci-MUPa-Srbije-nisu-prosli-provere-na-Kosovu>

policore gjatë viteve të shërbimit në Ministrinë e Brendshme të Serbisë.⁵ Programi ishte dizajnuar në mënyrë specifike që policët të familjarizohen me sistemin ligjor të Kosovës dhe për t'i njohur ata me procedurat standarde të operacionit dhe pajisjet. Tri ditët e para të trajnimit kishin të bënin me kornizën ligjore të Kosovës dhe rregullat dhe rregulloret ekzistuese, e cila pjesë u zhvillua nga përfaqësuesit e EULEX-it.⁶ Dy ditët e mbetura ishin rezervuar për trajnim në terren, i cili zhvillua nga dy ekspertë të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, përfshirë edhe përdorimin e pajisjeve standarde, ushtrimin e qitjes dhe procedurat e radio komunikimit. Nga përfundimi i trajnimit përfituan gjithsejtë 285 policë serbë. [Smakiqi 2014] Policët ishin ndarë në pesë grupe. Grupi i parë i ashtuquajtur i grupi testues, përbëhej nga 17 policë, grupet pasuese përfshinin 60, 72, 85 dhe 52 policë, respektivisht. Deri me 19 dhjetor 2013, grupi i parë i policëve kishte përfunduar trajnimin e tyre, pas të cilit ata u certifikuan nga policia dhe u caktuan në postet e tyre në Veri.⁷ Policët u caktuan në detyra të reja në pajtim me përvojën e tyre të mëparshme të punës. Në përputhje me konceptin e policisë në komunitet, ata do të zbatojnë detyrat e tyre në vendet përkatëse ku banojnë, por nëse është e nevojshme mund të dërgohen edhe në pjesët e tjera të Kosovës. Në Bruksel ishte arritur pajtimi që të gjithë policët që i bashkëngjiteshin PK-së përkohësisht do të kryejnë detyrat policore të patrullimit të rregullt, pasi që për tu caktuar në pozita të reja, duhet të bëhet verifikimi i diplomave dhe gradave të tyre. Si rezultat, ata e pranuan uljen e përkohshme në pozitë për një apo dy grada nga gradat që i kishin mbajtur përpara si policë të MUP-it, deri sa të përfundojë verifikimi i shkollimit dhe përvojës së punës. [Djurić 2014] Policët pritej që të paraqisnin dosjet e tyre deri në prill 2014 [dosjet duhet të paraqiten personalisht pasi që këto të dhëna janë klasifikuar nga MUP-i si të fshehta],

5 Intervistë me Ismajl Smakiqin, Drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

6 Intervistë me Agron Rukiqin, Udhëheqës i Departamentit për Burime Njerëzore në Policinë e Kosovës.

7 Raporti *Gjendja aktuale e zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit*, 16 janar 2014, fq. 11.

dhe deri në qershor ato duhet të verifikohen. Ndryshimi në paga do tu paguhet në mënyrë retroaktive kur/ nëse konfirmohen dhe do tu kthehen gradat ashtu si i kanë pasur përpara. [Djurić 2014]

Ndonëse u ngritën pikëpyetje lidhur me kohëzgjatjen e shkurtër të trajnimit, përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës insistojnë se trajnimi fillestar ishte i mjaftueshëm, duke marrë parasysh përvojën policore të ish pjesëtarëve të MUP-it. [Smakiqi&Rukiqi 2014] Megjithatë, ish pjesëtarët e MUP-it duhet të njoftohen menjëherë me kornizën ligjore të Kosovës dhe për përdorimin e pajisjeve të policisë [PK]. Në të kundërtën, ekspertët joqeveritarë të kësaj çështjeje pohojnë se periudha njëjavore e trajnimit është tepër e shkurtër për një integrim domethënës të ish pjesëtarëve të MUP-it në Policinë e Kosovës. Kjo është arsyeja pse disa palë të interesit, siç është misioni i OSBE-së në Kosovë, janë të interesuara në organizimin e trajnimeve plotësuese për zhvillimin e kapaciteteve të policisë, me kërkesën e MPB-së së Kosovës. Për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, Misioni i OSBE-së në Kosovë është ofruar që të bëjë një vlerësim të nevojave për trajnim në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, EULEX-in dhe ICITAP-in. Rezultatet e vlerësimit të nevojave do tu ndihmonin të gjitha palëve të interesit që të hartojnë një plan efektiv të trajnimit. Kohëzgjatja e trajnimit akoma nuk është përcaktuar, pasi që ajo bëhet krahas rezultateve të vlerësimit të nevojave, por sipas të gjitha gjasave ai do të jetë të paktën 18 muaj. [Mulliqi 2014]

Sfidat procedurale dhe organizative

Me përfshirjen e 285 policëve të ri serbë, përfaqësimi i pakicës serbe në polici është rritur në rreth 12.6% të numrit të përgjithshëm të punonjësve të PK-së. Megjithatë, meqë trajnimin në fund e përfunduan vetëm 285 nga 337 serbët që kishin qenë fillimisht në listë, nuk është dhënë përgjigje në pyetjen se çka ndodhi me 52 policët e tjerë. Janë disa mundësi: ata nuk kanë dashur t'i

bashkoheshin PK-së, ata kanë aplikuar por nuk i kanë plotësuar të gjitha kushtet ose nuk ishin gjetur nga PK ose EULEX-i i cili ishte angazhuar në fazën e rekrutimit. Deri në 10 policë serbë ishin refuzuar gjatë procesit të verifikimit për shkak se kishin vendbanimin e përhershëm në Serbi; disa thuhej se ishin refuzuar sepse tashmë kishin qenë policë të PK-së dhe ishin shkarkuar nga shërbimi para Marrëveshjes së Brukselit; dhe 8 policë të tjerë nuk e kishin kaluar verifikimin e sigurisë. (Djurić 2014) Stafi administrativ i policisë, i përbërë nga civilët që punonin për MUP-in në Veri, ishin përjashtuar nga kjo fazë e procesit dhe integrimi i tyre mbetet të vendoset në të ardhmen.

Përveç integritimit të ish pjesëtarëve të MUP-it në PK, Marrëveshja përcakton edhe themelimin e Komandës Rajonale të Policisë në Veri, me drejtor rajonal për katër komunat veriore (Mitrovicën Veriore, Zveçanin, Zubin Potokun dhe Leposaviqin). Komanda Rajonale e PK-së në Veri përfshin katër stacione policore dhe është komanda e shtatë dhe e fundit rajonale e policisë që duhet të themelohet në Kosovë. Po ashtu, sipas nenit 9 të Marrëveshjes, komandantit rajonal i policisë do të jetë serb i Kosovës i emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës në bazë të rekomandimeve nga kryetarët e katër komunave veriore me shumicë serbe. Do të jetë edhe një komandant rajonal për komunat e Mitrovicës Jugore, Skenderajt dhe Vushtrrisë. Komandanti rajonal për katër komunat veriore do të bashkëpunojë me komandantët e tjerë rajonalë. Gjatë negociatave të Brukselit, Komisioni Parlamentar për Çështje të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës propozoi që të krijohet një komandë rajonale për tërë rajonin e Kosovës Veriore, përfshirë Vushtrrinë, Skenderajn dhe Mitrovicën Jugore, por qeveria e Serbisë nuk e pranoi këtë propozim. Kuvendi i Kosovës po ashtu e kundërshtoi fuqishëm emërimin e komandantit rajonal aktual, për shkak të pikëpyetjeve rreth asaj se kujt ndaj kujt do të jetë përgjegjës ai. (Marinković 2014)

Sipas kategorizimit të PK-së, stacioni i policisë në Mitrovicën Veriore ishte stacioni i kate-

gorisë B, me 110-120 policë, numër i cili pas integritimit do të rritej në gati 170. Kjo mund të çoi në ri-kategorizimin e tij dhe në mundësinë për të krijuar njësi të reja, si njësinë e trafikut, njësinë e hetimeve dhe/ose njësinë e intervenimit. (Djurić 2014) EULEX-i ka një rol të rëndësishëm në mesin e aktorëve në këtë proces pasi që ai akoma ka fuqi ekzekutive në Kosovën Veriore. Një prej roleve të tij është roli monitorues dhe këshillues në procesin e vendimmarrjes së komandantit rajonal.

Në mënyrë që të ofrojë mbështetje të qëndrueshme financiare, qeveria e Kosovës ka ofruar një buxhet të veçantë për Kosovën Veriore, dhe pagat e policëve mbulohen nga ai buxhet. Pasi që çështja e pagesave ishte pikë kontestuese ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, neni 7 i Marrëveshjes e përcakton qartë se pagat e policisë në Veri duhet të paguhen ekskluzivisht nga Qeveria e Kosovës. Prandaj, qeveria e Serbisë ka lëshuar një dekret (dhjetor 2013) me të cilin i ka dërguar të gjithë pjesëtarët e MUP-it që kanë vepruar në Kosovë në pensionim të detyrueshëm. Sipas këtij dekreti, Serbia do të vazhdojë tua paguajë 60% të pagës së tyre të fundit të gjithë pjesëtarëve të MUP-it si pension. Megjithatë, që nga 28 shkurti 2014, policët e pensionuar nuk kanë marrë asnjë pagesë të pensionit nga qeveria e Serbisë.

SFIDAT E MBETURA NË ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BRUKSELIT

Marrëveshja e Brukselit është konsideruar si diskriminuese nga pjesëtarët e MUP-it që jetojnë në pjesën tjetër të Kosovës, të cilët sipas kësaj Marrëveshjeje janë pensionuar në mënyrë të detyrueshme nga Qeveria e Serbisë⁸ dhe janë lënë jashtë procesit të in-

8 Qeveria e Republikës së Serbisë, 2013, *Uredba o uslovima za ostvarenje prava na posebnu penziju za poslenih u Ministarstvu unutrašnjih postova na teritoriji AP Kosovo i Metohija*, Gazeta Zyrtare RS, Nos. 55/05, 71/05

tegrimit.⁹ Kjo ka krijuar njëfarë pakënaqësi në mesin e pjesëtarëve të MUP-it, të cilët për momentin besojnë se u mungon qasja në ndonjë punësim domethënës. Të pakënaqur me atë që ata e konsiderojnë të jetë dekretet jokushtetues dhe joligjor nga qeveria e Serbisë, mbi një mijë policë që veprojnë në Kosovë kanë protestuar në dhjetor të vitit 2013, dhe parashihen protesta të reja nëse qeveria nuk u përgjigjet ankesave të tyre.¹⁰ Përveç kësaj, rreth 800 pjesëtarë të pensionuar të MUP-it nga gjithsejtë 1200 sa kanë qenë në Kosovë, kanë paraqitur ankesa dhe kanë filluar procedurat administrative në gjykatat e Serbisë, duke pretenduar se pensionimi i tyre ishte shkelje e Ligjit të Serbisë për Policinë dhe Ligjin për Pensionet dhe Sigurimin për Aftësi të Kufizuara. [Djordjević 2014] Për adresimin e këtyre shqetësimeve, MPB-ja e Serbisë ka krijuar një grup punues për hartimin e një *lex specialis* për pensionimin e policëve nga Kosova dhe Metohia. Hartimi dhe miratimi i këtij ligji mund të vonohet si rezultat i zgjedhjeve dhe i qeverisë së re në Serbi.

Sipas raporteve të mediave, procesi i integritit fillimisht ishte zhvilluar në atmosferë shumë pozitive dhe optimiste, pasi që Marrëveshja ishte pranuar gjerësisht si nga politikanët në Kosovë ashtu edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Megjithatë, më vonë, zyrtarët serbë dhe shqiptarë që ishin drejtpërdrejtë të përfshirë në negociatë dhanë disa deklarata ku paraqisnin interpretime të ndryshme dhe shpesh kontradiktore të Marrëveshjes, të cilat e hutuan edhe më shumë publikun në përgjithësi por edhe politikanët,

9 Të gjithë policët e MUP-it që operonin në Kosovë janë pensionuar në dhjetor 2013, pavarësisht përvojës së tyre të mëhershme të punës. Derisa ata nga veriu ishin përfshirë në procesin e integritit, ish oficerët e MUP-it që jetojnë në jug të lumit Ibër u pensionuan dhe mbetën pa mundësi për të punuar, edhe pse disa prej tyre ishin në fillim viteve të njëzeta.

10 Vesti online, <http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/373572/Silom-nas-teraju-u-penziju>
Blic, <http://www.blic.rs/Vesti/Drustvo/433104/Sindikativ-traze-usvajanje-novog-zakona-o-penzionisanju-policijaca-sa-KiM>

RTS, <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/125/Dru%C5%A1tvo/1473861/Nezadovoljstvo+zbog+penzionisanja+ju%C5%BEEno+od+lbra.html>

TV Most, http://www.tvmost.info/vesti/sindikati_policije_usaglasili_stavove/3302

anëtarët e parlamentit dhe palët e tjera të përfshira. [Delić 2013] Në vend se ta bënte gjithë këtë proces më transparent, kjo shkaktoi edhe më shumë huti. Ata që prekeshin drejtpërdrejt nga Marrëveshja, pjesëtarët e MUP-it në Veri, nuk kishin qasje në informacione rreth këtij procesi dhe se çka pritej prej tyre. Për më tepër, ata ishin lënë krejtësisht jashtë negociatave të Brukselit, i cili në masë të madhe shihej si proces i zhvilluar nga elitat dhe si i tillë konsiderohej jolegjitim nga ata që ishin të prekur nga procesi por që nuk merrnin pjesë në të. Ketë e mbështet një intervistë me një ish punonjës të MUP-it, i cili theksoi se nuk e dinte çka të priste dhe se ndihej shumë i pasigurt për perspektivën e tij ardhme dhe për mirëqenien financiare pasi që pagesat e pensioneve nga qeveria e Serbisë ishin vonuar. Ai po ashtu theksoi se ekziston një ndjenjë e përgjithshme e pakënaqësisë në radhët e kolegëve të tij për atë se si pala serbe i ishte qasur kësaj situatë. [Një ish pjesëtar i MUP-it 2014] Kjo pikëpamje vërtetohet më tej me faktin se para fillimit të procesit të integritit dhe trajnimit fillestar, ish pjesëtarët e MUP-it bazoheshin në informatat që u ishin dhënë nga Komandanti i sapoemëruar për Veriun, Z. Djurić, për atë se si do të bëhet trajnimi dhe çka do të pritët nga ata. Kishte shumë pak informata në dispozicion për pjesëtarët e MUP-it, të cilët duhej të bazoheshin në kontaktet e tyre personale me ata që ishin më lartë në hierarkinë e policisë për tu siguruar se ishin të informuar si duhet rreth procedurës. [Djurić 2014]

Duket se procesi i integritit të pjesëtarëve të MUP-it nga shumica e palëve të përfshira ishte konsideruar si proces “teknik” i cili duhej të kryhej kur grupi i fundit i pjesëtarëve të kenë përfunduar trajnimin dhe të jenë caktuar në detyrat e tyre. Ka një mungesë të qartë të një qasjeje më gjithëpërfshirëse dhe afatgjate e cila në periudhën e ardhshme duhet të fokusohet në ndërmarrjen e masave për ndërtimin e besimit, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, d.m.th, perceptimin e publikut për performancën e tyre, pranimin nga pjesëtarët e komunitetit, organizimin e trajnimeve plotësuese, etj.

PËRFUNDIM

Marrëveshja e Brukselit është rezultat i kompromisit politik i cili padyshim se është një hap përpara në marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Edhe pse ai është lavdëruar si një zhvillim i ri në marrëdhëniet Beograd-Prishtinë, në të njëjtën kohë Marrëveshja e Brukselit ka shkaktuar pakënaqësi të madhe tek palët e ndryshme të interesit, si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, e veçanërisht te serbët që jetojnë në jug të lumit Ibër, të cilët ishin lënë jashtë këtij procesi. Zbatimi i suksesshëm i Marrëveshjes mbetet në pikëpyetje.

Procesi i integrimit të policëve serbë në Policinë e Kosovës sipas Marrëveshjes ka mbetur prapa afateve të dakorduara kohore. Për shkak të këtyre rrethanave, policët por edhe qytetarët e Kosovës dhe disa parti opozitare, ishin skeptikë për këtë proces dhe për zbatimin e tij të plotë dhe në mënyrë profesionale. Megjithatë, dispozitat e Marrëveshjes që kanë të bëjnë me sigurinë janë zbatuar me sukses në fillim të shkurtit, kohë kjo kur 285 ish pjesëtarë të MUP-it u integruan në PK. Një hap tjetër përpara në zbatimin e Marrëveshjes ishte krijimi i Komandës Rajonale të PK-së për Veri. Megjithatë ka shumë paqartësi lidhur me procesin. Një prej dobësive të procesit të integrimit është se ai u zhvillua shumë shpejt, duke lënë mjaft çështje të pazgjidhura, siç është procesi i verifikimit, integrimi i stafit administrativ të policisë, pensionet dhe çështja e pensionimit të detyrueshëm.

Meqë Marrëveshja e Brukselit dhe zbatimi i saj është një “proces që udhëhiqet nga elita”, elitat politike në Kosovë dhe Serbi konsiderohen kontribuuesit kryesorë, por ata po ashtu konsiderohen se janë në gjendje të pengojnë zbatimin e saj në terren. Pasi që kjo është një çështje shumë e ndjeshme politike, zbatimi i këtij aspekti të Marrëveshjes është mbajtur larg syrit të publikut. Mungesa e informatave ka krijuar një ambient të përshatshëm për interpretime të ndryshme të Marrëveshjes, duke lënë po ashtu hapësirë për deklarata të ish pjesëtarëve të MUP-it për

sigurinë dhe për paraqitjen e tyre në media si element që rrezikon dhe është i dëmshëm për interesat e sigurisë kombëtare të Kosovës. Që Marrëveshja të zbatohet me sukses integrimi i pjesëtarëve të MUP-it duhet të mbështetet nga udhëheqësit politikë të të dy komuniteteve dhe të pranohet nga qytetarët e Serbisë dhe të Kosovës. Përveç kësaj, për ta bërë këtë proces më të qëndrueshëm, është e nevojshme që të bëhen ndryshime në sistemet ligjore të Serbisë dhe Kosovës.

BIBLIOGRAFIA

Legjislacioni dhe publikimet qeveritare:

- Qeveria e Republikës së Kosovës 2014, *Gjendja e Zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit*. Raport dërguar Bashkimit Evropian. Qeveria e Republikës së Kosovës.
- Qeveria e Republikës së Serbisë 2013, *Uredba o uslovima za ostvarenje prava na posebnu penziju zaposlenih u Ministarstvu unutrašnjih postova na teritoriji AP Kosovo i Metohija*, Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 55/05, 71/05
- Qeveria e Republikës së Kosovës 2008, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës 2008, *Ligji për Policinë e Kosovës 03/L-035*. Prishtina, Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës 2010, *Ligji për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë 03/L-178*. Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Raportet dhe publikimet:

- Dokument Pune i Stafit të Komisionit Evropian 2013, Raporti i Progresit për Kosovën* 2013, shikuar me 3 mars 2014, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf
- Dokument Pune i Stafit të Komisionit Evropian 2013, Raporti i Progresit për Serbinë 2013, shikuar me 3 mars 2014, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/sr_rapport_2013.pdf
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave 2009, *Integrimi serb në Kosovë: Vendimi për të ecur përpara*. Raporti për Evropën Nr. 200, shikuar me 28 shkurt 2014, https://www.cimicweb.org/cmo/ComplexCoverage/Documents/Kosovo/Current%20Documents/200_serb_integration_in_kosovo___taking_the_plunge_2009.pdf

- Grupi Ndërkombëtar i Krizave 2011, *Kosova Veriore: Sovraniteti i Dyfishtë në Praktikë*. Raporti për Evropën Nr. 211, shikuar me 5 mars 2014, <https://www.cimicweb.org/cmo/ComplexCoverage/Documents/Kosovo/Current%20Documents/211%20North%20Kosovo%20---%20Dual%20Sovereignty%20in%20Practice.pdf>
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave 2012, *Kosova pa Mbikëqyrje: Sfidat e Mbetura*. Raporti për Evropën Nr. 218, shikuar me 7 mars 2014, [http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/218-setting-kosovo-free-remaining-challenges.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/balkans/kosovo/218-setting-kosovo-free-remaining-challenges.pdf)
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave 2013, *Serbia dhe Kosova: Rruga drejt Normalizimit*. Raporti për Evropën Nr. 223, shikuar me 14 mars 2014, <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/223-serbia-and-kosovo-the-path-to-normalisation.pdf>
- Innovation for Successful Societies 2012, *Building the Police Service in the Security Vacuum: International Efforts in Kosovo, 1999-2011*. Princeton University.
- EULEX Programme Report 2012, *EULEX: Rule of Law beyond the Headlines*, http://www.eulex-kosovo.eu/docs/Accountability/2012/EULEX_Programme_Report_2012-HighQuality.pdf
- OSBE 2001, Vlerësimi i Gjendjes së Pakicave Etnike në Kosovë, Prishtinë.
- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë 2013, *Barometri i Sigurisë në Kosovë*. Botimi i tretë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë, shikuar me 21 janar 2014, http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_Third_Edition_20786.pdf
- Saferworld dhe FIQ 2008, *Policimi në Kosovë*, Forumi për Iniciativa Qytetare, Saferworld, shikuar me 26 shkurt 2014, <http://www.saferworld.org.uk/downloads/pubdocs/English.pdf>
- Green, M, Friedman, J & Bennet, R 2012, *Building the police service in a security vacuum: International Efforts in Kosovo 1999-2011*, Princeton University, <https://www.princeton.edu/successfulsocieties/>

content/data/policy_note/PN_id121/Policy_Note_ID121.pdf

- Emmini, D 2013, *Përfshirje apo përjashtim – Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e pas-pavarësisë*, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë.
- Malazogu, L et al. 2014, *Integrim apo izolim? Kosova Veriore në qorrsokakun zgjedhor 2014*, Instituti qendror i Politikave Evropiane [CEPI], Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë [QBPS], Demokracia për Zhvillim, Instituti Polak për Çështje Ndërkombëtare [IPÇN].
- Bassuener, K & Weber, B 2013, *Not Yet a Done Deal: Kosovo and the Prishtina-Belgrade Dialogue*. Democratization Policy Council [DPC], Berlin.
- Jureković, P 2013, “Kosovo Agreement – Implementation as Litmus Test”, *IFK Monitor International*, Austrian National Defence Academy, Vienna.

Artikujt e gazetave:

- Andrić, G, “Serb to Run Police in North Kosovo”, *Balkan Insight*, 6 dhjetor 2013, shikuar me 10 shkurt 2014, <http://www.balkaninsight.com/en/article/belgrade-prishtina-reach-deal-on-kosovo-north-police>
- Beograd – “Kosovo Agreement Text Published”, in *Serbia, Independent News*, 19 prill 2013, shikuar me 10 shkurt 2014, <http://inserbia.info/news/2013/04/belgrade-kosovo-agreement-text-published/>
- Delić, P, “Policajci idu u penziju, a onda u KPS”, *Akter*, 15 dhjetor 2013, shikuar me 10 shkurt 2014, <http://akter.co.rs/weekly/34-bezbednost/65427-policajci-idu-u-penziju-a-onda-u-kps.html>
- Zejneli, A, “Nejasnoce iz sporazuma komplikuju integraciju policije”, *Radio Slobodna Evropa*, 13 dhjetor 2013, shikuar me 10 shkurt 2014, <http://www.slobodnaevropa.org/content/nejasnoce-iz-sporazuma-komplikuju-integraciju-policije/25199654.html>
- Živković, R, “Integracija Srba u bezbednosne strukture”, *Akter*, 3 nëntor 2013, shikuar me 10 shkurt 2014, [co.rs/weekly/33-politika/59426-integracija-srba-u-bezbednosne-strukture.html](http://akter.

</div>
<div data-bbox=)

- Petković, J “Rampa za Srbe u kosovskoj policiji”, *Vesti online*, 13 dhjetor, shikuar me 20 mars 2014, <http://www.vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/367376/Rampa-za-Srbe-u-kosovskoj-policiji>
- RTS 2013, “Integracija bivših srpskih policajaca u KPS”, *RTS*, 14 Dhjetor, shikuar me 20 mars 2014, <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1470483/Integracija+biv%C5%A1ih+srpskih+policajca+u+KPS.html>
- Marrëveshja e parë për Parimet e Normalizimit të Marrëdhënieve [Marrëveshja e Brukselit], 19 prill 2013, mund të merret në: http://www.danas.rs/danasrs/politika/prevod_sporazuma_koji_je_danas_parafiran_u_briselu.56.html?news_id=259487
- Plani i zbatimit, 2 maj 2013, mund të merret në: <http://euobserver.com/media/sr/c/0807580ad8281aefa2a89e38c49689f9.pdf>
- Standardi.info 2013, “Sfidë verifikimi i MUP-ve serb dhe integrimi në policinë e Kosovës”, 6 dhjetor, shikuar me 25 mars 2014, <http://standardi.info/index.aspx?SID=13&LID=2&AID=140697&Ctype=1&ACatID=11>.
- Zëri 2013, “Thaçi: Nga nesër mund të fillojë integrimi i serbëve në PK”, 6 Dhjetor, shikuar më 25 mars 2014, <http://www.zeri.info/artikulli/22302/fillon-takimi-thaci-daciq-ne-bruksel>

Shtojca 1. Intervistat

- Besim Jonuzaj, Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Departamentit për Regjistrim Civil, Agjencia e regjistrimit Civil e Kosovës [ARC], në Prishtinë, 25 shkurt 2014.
- Shpresa Mulliqi, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në Prishtinë, 26 shkurt 2014.
- Carsten Twelmeier, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në Prishtinë, 26 shkurt 2014.
- Agron Rukiqi, Drejtor i Departamentit për Burime Njerëzore në Policinë e Kosovës, në Prishtinë, 26 shkurt 2014.

- Ismajl Smakiqi, Drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Civile, në Vushtrri, 27 shkurt 2014.
- Avni Istrefi, Kryesues i Zyrës për Zhvillim, Planifikim dhe marrëdhënie të Jashtme, Akademia e Kosovës për Siguri Civile, në Vushtrri, 27 shkurt 2014.
- Shpresa Muharremi, Këshilltar në Akademinë e Kosovës për Siguri Civile, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në Vushtrri, 27 shkurt 2014.
- Intervista me dy zyrtarë të policisë, Stacioni i Policisë në Graçanicë, 28 shkurt 2014.
- Ahmet Isufi, Kryesues i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 3 mars 2014.
- Goran Marinković, Zëvendës kryesues i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, në Prishtinë, 5 mars 2014.
- Alessandro Tedesco, Menaxher i Programit, Zyra e EULEX për Planifikim, Koordinim dhe Respektim, në Prishtinë, 6 mars 2014.
- Nenad Djurić, ushtrues detyre i Komandantit Rajonal për Kosovën Veriore, në Mitrovicë, 7 mars 2014.
- Predrag Djordjević, Kryetar i Sindikatës së Pavarur të Policisë (*Nezavisni sindikat policije*, e cila nuk duhet ngatërruar me *Samostalni sindikat policije*), në Prishtinë, 7 mars 2014.
- Intervistë me një ish pjesëtar të MUP-it nga Veriu, tani i integruar në Policinë e Kosovës, në Leposaviq, 10 mars 2013.

PËR AUTORËT

Maja BJELOŠ është diplomuar në Studime Ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Politike, Universiteti në Beograd, ku edhe ka përfunduar programin Master në Sigurinë Ndërkombëtare. Që nga viti 2009 ajo është angazhuar si hulumtuese në BCSP. Maja ka specializuar në çështje gjinore dhe reformën e sektorit të sigurisë në Serbi, duke publikuar raporte të ndryshme të tilla si politikës e sigurisë në Serbi, Siguria Evropiane dhe sektori i sigurisë në Serbi, si dhe përfaqësimi i pakicave kombëtare në reformën e sektorit të sigurisë në Serbi. Gjithashtu, Maja është bashkë - redaktore ne gazetën Aspektet Gjinore dhe Siguria.

Bojan ELEK. është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike, Universiteti i Beogradit, dhe përfundoi studimet Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane në Universitetin e Evropës Qendrore në Budapest. Bojan është angazhuar në BCSP si hulumtues që nga viti 2013. Para se ti bashkohej BCSP, Bojan ishte i angazhuar si anëtar i ekipit PR në kuadër të Fakultetit të Shkencave Politike dhe vullnetarë në organizata të shoqërisë civile. Gjatë studimeve të tij, ai kaloi një vit në trajnim profesional në Universitetin George Mason në SHBA, si një studiues i Institutit të Shoqërisë së Hapur. Interesat e tij kërkimore janë zgjerimi i BE-se, konflikti etnik, ndërtimi i paqes dhe shoqëritë pas konfliktit.

Fjolla RAIFI është diplomuar në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane në Universitetin Amerikan të Selanikut, Greqi, duke kompletuar një semestër në Universitetin Northern Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Fjolla është angazhuar në QKSS që nga viti 2012 si Hulumtuese dhe Bartëse e Projektit. Para se ti bashkohej QKSS-së, Fjolla ishte e angazhuar në organizata të ndryshe lokale dhe ndërkombëtare.

PËR ORGANIZATAT

QENDRA E BEOGRADIT PËR POLITIKA TË SIGURISË (BCSP)

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë (BCSP) është një think-tank i pavarur që nga viti 1997 duke avokuar publikisht për sigurinë kombëtare dhe njerëzore të bazuar në demokraci dhe të drejtat e njeriut. BCSP punon në drejtim të konsolidimit të sektorit të sigurisë (RSS) dhe integritit të sigurisë të shteteve të Ballkanit Perëndimor në bashkësinë Euro-atlantike, duke krijuar një mjedis të politikave të sigurisë bazuar në njohuri gjithëpërfshirëse. Te gjitha këto objektiva i arrin nëpërmjet hulumtimit, avokimit publik, arsimimit, si dhe duke sjellë së bashku palët e interesuara për krijimin e kontakteve dhe bashkëpunimeve të ndryshme.

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (KCSS)

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2008 me qëllim kryesor të zhvillojë studimet kërkimore-shkencore, në sektorin e sigurisë. QKSS zhvillon hulumtime dhe organizon konferenca dhe seminare në fushën e politikave të sigurisë, sundimit të ligjit, drejtësisë, dhe monitorimin e sektorit të sigurisë. Aktivitetet e QKSS-së kontribuojnë në forcimin e parimeve të mbikëqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

ABOUT PROJECT

The Security Research Forum is a joint project of three independent think tanks from Belgrade (BCSP), Prishtina (KCSS) and Tirana (IDM) specialized in research of security issues. The Security Research Forum is meant to foster balanced debate among think-tank community, academia, public policy and media in order to provide research-based alternative solutions to ongoing challenges of cooperation among Serbia, Kosovo and Albania.



